

STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ GAEA 90” SH.P.K.

KAPITULLI I
EMËRTIMI, FORMA, OBJEKTI I VEPRIMTARISË, SELIA, KOHËZGJATJA

NENI 1
EMËRTIMI DHE FORMA E SHOQËRISË

1.1 Shoqëria “GAEA 90” SHPK, është e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar dhe përbëhet nga ortakët e mëposhtëm:

1. Z. Gentjan Abazi I biri Shpëtim, lindur në datë 13.11.1990 në Tiranë e me banim në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtësi i lehtënjofimit me numër personal J01113057J
2. Znj. Shpëtim Abazi, i biri i Ismailit, lindur në datë 15.05.1963 në Vleshë, dibër e me banim në Tiranë , madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i lehtënjofimit me numër personal G30515235L

1.2 Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “GAEA 90” SHPK.

NENI 2
BAZA LIGJORE

- 2.1 Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, si dhe të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë pozitën juridike të veprimtarisë private.
- 2.2 Kjo shoqëri fiton zotësinë për të vepruar me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



NENI 3 OBJEKTI

3.1 Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është:

Këmbim valutor, agjensi udhëtimi, shërbim pagesash online OSHEE, UKT etj.

NENI 4 SELIA

4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga Barriakdave, pallati pll.131 sh.1, kati 1, , njësia administrative nr. 9 Tiranë

NENI 5 KOHEZGJATJA

5.1 Shoqëria ka një kohëzgjatje të pacaktuar. Ajo mund të përfundojë veprimtarinë përpara këtij afati në rastet e prishjes, falimentimit ose të likuidimit të shoqërisë të parashikuara këto në legjislacionin tregtar shqiptar në fuqi.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR DHE KUOTAT

NENI 6 KAPITALI THEMELTAR

6.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është 2 500 000 (dy milion e pesëqind mijë) Lekë i ndarë në 2 (dy) kuota. Çdo kuota njësi jep të drejtën e një vote. Kapitali themeltar i shoqërisë nënshkruhet tërësisht nga Ortakët.

6.2 Pjesët e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga Ortakët, si më poshtë vijon:

- **Ortaku Gentjan Abazi**, zotëron 1 (një) kuota, të barabartë me 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar.
- **Ortaku Shpetim Abazi**, zotëron 1 (një) kuota, të barabartë me 50% (pesëdhjetë) të kapitalit themeltar.

NENI 7 TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT THEMELTAR

7.1 Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial, nëpërmjet:

- a) shitblerjes;
- b) trashëgimisë;
- c) dhurimit;



d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

7.3 Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen edhe të tretëve, por pasi të jetë ushtruar dhe refuzuar e drejta e parablerjes nga ortakët e shoqërisë dhe këta të kenë hequr dorë shprehimisht nga kjo e drejtë.

NENI 8 ZMADHIMI/ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

8.1 Ortakët/ortaku nuk kufizohen në rritjen e kapitalit themeltar. Zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet nga Ortakët/ortaku deri në kufijtë e parashikuar nga ligji.

8.2 Raporti i zmadhimit ose zvogëlimi të kapitalit miratohet në mënyrë të shprehur nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë të paktën $\frac{3}{4}$ e pjesëve të kapitalit themeltar.

KAPITULLI III ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË DHE KOMPETENCAT E TYRE

NENI 9 ORGANET DREJTUESE

9.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:


- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori.

NENI 10 ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, KOMPETENCAT E SAJ

10.1 Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues i shoqërisë.

10.2 Asambleja e Përgjithshme drejton veprimtarinë e shoqërisë nëpërmjet marrjes së vendimeve. Vendimet që mund të marrë Asambleja e Përgjithshme përfshijnë kryesisht vendime për:

- Përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- Ndryshimet në Statut;
- Rritjen ose zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë;
- Shitjen, transferimin dhe anulimin e kuotave të kapitalit themeltar;
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- Emërimin dhe shkarkimin e Ekspertit kontabël dhe të likuidatorëve si dhe caktimin e shpërblimit të tyre.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, duke përfshirë edhe përgatitjen e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Miratimin e pasqyrave financiare dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Lëshimin e çertifikatës së aftësisë paguese të shoqërisë;



- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

NENI 11 THIRRJA DHE ZHVILLIMI I MBLEDHJEVE

- 11.1 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret në çdo kohë nga Administratori ose një apo disa ortakë që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të pjesëve të kapitalit themeltar. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së përgjithshme thirret të paktën 1(një) herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 11.2 Mbledhjet zhvillohen në selinë e shoqërisë ose në çdo vend tjetër të njoftuar nga Administratori.
- 11.3 Njoftimi kryhet me shkrim ose me postë elektronike jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së zhvillimit të mbledhjes dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

NENI 12 MARRJA E VENDIMEVE

- 12.1 Asambleja e Përgjithshme, në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kuotave.
- 12.2 Vendimet e Asamblesë, për të cilat kërkohet një shumicë e kualifikuar, sipas përcaktimit të nenit 12, pika 3, të këtij Statuti, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm në mbledhje ortakët që zotërojnë më shumë se 50% (pesëdhjetë përqind) të numrit total të votave.
- 12.3 Asambleja e Përgjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjes së fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 12.4 Nëse Asambleja nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në nenin 12, pikat 1 dhe 2 të këtij Statuti, Asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
- 12.5 Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratori përgjigjet për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme. Procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

NENI 13 ADMINISTRATORI, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E TIJ

- 13.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë.



- 13.2** Shoqëria do të administrohet nga Z. Gentjan Abazi I biri Shpëtim, lindur në datë 13.11.1990 në Tiranë e me banim në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtësi i lehtënjofimit me numër personal J01113057J, madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar;
- 13.3** Administratori ka të drejtë e detyrohet:
- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
 - Të përfaqësojë shoqërinë tregtare në marrëdhëniet me të tretët personalisht ose duke caktuar zëvendësues;
 - Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
 - Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë;
 - Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - Të kryejë regjistrimet dhe të dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sipas parashikimeve të ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
 - Të raportojë para Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë.
- 13.4** Administratori emërohet për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërtëritjeje.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI DHE FITIMET

NENI 14 VITI FINANCIAR

- 14.1** Viti financiar i shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.
- 14.2** Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 Dhjetor 2021.
- 14.3** Shoqëria përgjigjet për kontributin fiskal, afatet e derdhjes së tij, sigurimet shoqërore etj. Ajo ka të drejtë të çelë llogari likuiduese pranë bankave dhe të kryejë veprime likuiduese me to, brenda dhe jashtë vendit.
- 14.4** Llogaritë vjetore, inventarët, raportet mbi operacionet e vitit financiar miratohen nga Asambleja e Ortakëve të shoqërisë.
- 14.5** Miratimi i dokumenteve që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.



NENI 15
BILANCI, MBAJTJA E KONTABILITETIT

- 15.1** Bilanci vjetor i shoqërisë duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore deri në fund të muajit Mars të vitit pasardhës.
- 15.2** Kontabiliteti mbahet në gjuhën dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë të cilat do të konvertohen çdo muaj në monedhën shqiptare.
- 15.3** Pas shlyerjes së detyrimeve fiskale ndaj shtetit, fitimi neto mund të përdoret për zgjerimin e aktivitetit, për rritjen e kapitalit të shoqërisë ose i shpërndahet ortakëve sipas kuotave të zotëruara.


NENI 16
FITIMET

- 16.1** Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë, në raport me kuotat që ata zotërojnë.
- 16.2** Të ardhurat që do të rezultojnë deri në fund të mbylljes së çdo viti ushtrimor, mund të ndahen ndërmjet ortakëve në raport me pjesët që ata zotërojnë në kapitalin e shoqërisë, vetëm nëse:
- Aktivët e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;
 - Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KAPITULLI V
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

NENI 17
PRISHJA E SHOQËRISË

- 17.1** Shoqëria prishet:
- në përfundim të afatit të parashikuar nga Statuti;
 - me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - me vendim të gjykatës.
- 17.2** Administratori do të regjistrojë vendimin për prishjen e shoqërisë, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Tregtare të Regjistrimit". Në rast se prishja e shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata ia njofton vendimin Qendrës Kombëtare për Regjistrim.



NENI 18



LIKUIDIMI I SHOQËRISË

- 18.1** Në rast prishjeje shoqëria duhet të likuidohet.
- 18.2** Për të administruar këtë procedurë, Asambleja e Ortakëve emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raporte përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 18.3** Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja vendos mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesit dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 18.4** Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit Ortakëve të shoqërisë, në proporcion me kuotat e kapitalit të zotëruara prej tyre.
- 18.5** Likuidatori/ët njoftojnë Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e procesit të likuidimit duke kërkuar çregjistrimin e shoqërisë në përputhje me parashikimet e ligjit "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 19 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 19.1** Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij Statuti, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.
- 19.2** Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje të mosmarrëveshjeve me mirëkuptim, ato do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

KAPITULLI VI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

NENI 20

- 20.1** Ky statut është hartuar në përputhje me:
- i) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;
 - ii) Ligjin Nr. 9723, datë 03/05/2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" i ndryshuar.
- 20.2** Për çështje që nuk janë shprehur plotësisht në këtë Statut, shoqëria i referohet Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- 20.3** Ky Statut, përbëhet nga 20 nene dhe u redaktua në 3 (tre) kopje identike në gjuhën shqipe, duke patur të gjitha fuqi të njejtë ligjore.



ORTAKËT

GENTJAN ABAZI

GENTJAN ABAZI 

SHPETIM ABAZI

Shpetim Abazi 